



Planimar / Dokument Prilipi / Pr. lista Received / Doc. listy	13.01.2022	viti god year	2
Organ / Bësitë Organ / Jedinstvo Org. Unit	Nr. Pril. / Pril. No.	Shënim / Pril. g. Appendix	Sasia Kolicitimi Quantity
SKPM/SHCK	132/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1057/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj- Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1644/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.215/2020 të datës 04.08.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Vendimit KA.nr.19/2020 të datës 03.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 10.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.215/2020 e datës 04.08.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.19/2020 i datës 03.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga pranimi i të njëjtit, duke e kthyer ankuesin në pozitën e punës Referent sipas Akt Emërimit me numër protokoll 115/17 të datës 18.09.2017.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datë 04.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 1476 të regjistruar me numër A.nr.215/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kundër Vendimit Nr.19/2020 të datës 03.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak

të vërtetimit të gabuar dhe jo të drejt të gjendjen faktike, mos aplikimit të drejt të dispozitave ligjore dhe shkeljeve procedurale. E njëjta me datë 06.01.2022 është plotësuar dhe precizuar përmes parashtresës me numër protokollit 21/2022, me pretendimin ankimor për kthimin e tij në pozitën e punës Referent, si dhe kompensimin e pagave që nga emërimi i tij në pozitën përkatëse, me datë 18.09.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.08.2020 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 16.09.2020, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.09.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 1791/2020 e ka njoftuar ankuesen lidhur me pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e datës 04.08.2020 për shkak të mungesës se kuorunit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që t'i ndjek procedurën e përcaktuar me dispozitat e LKA-se. Ankuesi, kundër këtij njoftimi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.1644/2020 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që të shqyrtoje dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 13.04.2020 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1476/2020 të regjistruar me numër A.nr.215/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1644/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Parashtresën me numër protokollit 21/2022 të datës 06.01.2022; E-mail nga B.B. për C.Z, të datës 16.09.2020; E-mail nga C.Z. për B.B, të datës 16.09.2020; Njoftimin e datës 16.09.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.08.2020; Kërkesën për kthim në vendin e punës të datës 09.03.2020; Vendimin Nr.128/19 të datës 05.03.2019 për pezullim parandalues; Vendim me Nr.K.D.05/2020 të datës 18.05.2020; Vendimin me KA.nr19/2020 të datës 03.07.2020; Ankesën e datës 12.06.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Aktgjykimin P.nr.291/19 të datës 15.01.2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm; Akt Emërimit të datës 18.09.2017; Përgjigjen në ankesë të datës 16.09.2020; Deklaratën e datës 07.05.2020; Kërkesën me Nr.133/2020 të datës 21.04.2020 për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit B.B; Pliko e datës 15.09.2020; E-mailin e datës 31.12.2021 nga C.Z. për F.K; E-mailin e datës 06.01.2022 nga F.K për C.Z.; E-mailin e datës 10.08.2020 nga M.H për B.G; E-mailin e datës 05.01.2022 nga F.K për C.Z; Dëshmi lidhur me pagesën P.nr.291/19 i datës 23.06.2020; Pranimi i ankesës 09/614 i datës 10.07.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është pjesërisht e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokollit 115/17 të datës 18.09.2017 është emëruar në pozitën e punës Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me Vendimin me numër protokollit 128/19 të datës 05.03.2019 të Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ankuesi është pezulluar nga puna me pagesë 50 % të pagës bazë, për shkakun se Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte filluar hetimin penal ndaj



të njëjtit për vepër penale sipas nenit 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës.


Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktgjykimin me numër P.nr.291/19 të datës 15.01.2020, i plotfuqishëm nga data 05.03.2020, ka shpallur ankuesin fajtor për kryerje të veprës penale sipas nenit 401 paragrafi 2 të KPK-së, dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh, i cili dënim është zëvendësuar me dënimin me gjobë në vlerë prej një mijë (1000 euro).

Zëvendësuesi i Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 21.04.2020 ka parashtruar kërkesë pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje (SKGJK) për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me propozimin që Komisioni Disiplinor të shqiptoj masë disiplinore adekuate në raport me përgjegjësinë penale të vërtetuar me Aktgjykimin P.nr.291/19 të datës 15.01.2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Komisioni Disiplinor i SKGJK, përmes Vendimit K.D 05/2020 të datës 18.05.2020, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje disiplinore sipas nenit 6 pika 1.5 të Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy muaj nga Komisioni Disiplinor me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë"* si dhe masën disiplinore *"Rikthim në pozitën e dorëzuesit dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vite"*.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor, me datë 12.06.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK- së. Ky i fundit me Vendimin KA.nr.19/2020 të datës 03.07.2020, ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit të datës 12.06.2020 dhe ka ndryshuar Vendimin e Komisionit Disiplinor K.D 05/2020 të datës 18.05.2020 lidhur me masën disiplinore sipas pikës III të dispozitivit të këtij vendimi, ashtu që ka hequr masën disiplinore *"ndalim i gradimit deri në pesë (5) vite"*.

Kundër Vendimit Nr.19/2020 të datës 03.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të drejt të gjendjen faktike, mos aplikimit të drejt të dispozitave ligjore dhe shkeljeve procedurale. I njëjti me datë 06.01.2022 përmes parashtrësës me numër protokolli 21/2022 ka plotësuar ankesën e datës 04.08.2020, duke kërkuar kthimin e tij në pozitën e punës Referent, si dhe kompensimin e pagave që nga emërimi i tij në pozitën përkatëse, me datë 18.09.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore te ankuesit ju referua dispozitave të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 64 paragrafi 1 dhe 3 me të cilin përcaktohet se: *"1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji;... 3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore, nenit 63 paragrafi 1 ku parashihet se: Përgjegjësia personale për kryerjen e një vepre penale ose kundërvajtje gjatë ushtrimit të detyrave administrative nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit civil, me kusht që vepra gjithashtu të përbëjë shkelje të detyrës, siç është përcaktuar me këtë ligj; si dhe nenit 66 paragrafi 1 ku përcaktohet se: Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Andaj, ne kuptim te këtyre dispozitave ligjore, dhe duke marr parasysh Aktgjykimin me numër P.nr.291/19 të datës 15.01.2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovës, përmes të cilit ankuesi është shpallur përgjegjës dhe është dënuar me dënim me gjobë, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor ne kuadër te SKGJK-se, me rastin e nxjerrjes se Vendimit Nr.K.D 05/2020 të datës 18.05.2020 ka konstatuar drejte gjendjen faktike, mirëpo gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e shqiptimit të dy masave disiplinore*



njëkohësisht, gjegjësisht masën disiplinore nga neni 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, duke u bazuar në konstatimin si me lartë Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë SKGJK-së, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.19/2020 të datës 03.07.2020 ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin material, duke ndryshuar Vendimin K.D 05/2020 të datës 18.05.2020 të Komisionit Disiplinor, me ç'rast ka lenë në fuqi vetëm masën disiplinore sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi, gjegjësisht masën disiplinore "Pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy muaj nga Komisioni Disiplinor me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë " sipas nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, meqenëse Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, e ka shfuqizuar masën disiplinore nga pika 3 e dispozitivit të Vendimin K.D 05/2020 të datës 18.05.2020 të Komisionit Disiplinor, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për kthimin e tij në pozitën e punës Referent sipas Akt Emërimit me numër protokoli 115/17 të datës 18.09.2017, është i bazuar.

Ndërsa, pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e diferencës së pagave që nga emërimi në pozitën e punës Referent, gjegjësisht nga data 18.09.2017, është i pa bazuar, sepse Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankuesi me datë 18.09.2017 ka pranuar dhe rrjedhimisht nënshkruar Akt Emërimit me numër protokoli 115/17, për pozitën e punës Referent, me koeficient të pagës pesë (5) dhe nuk ka parashtruar ankese brenda afatit prej 30 ditësh siç përcaktohet me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.1057/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.